



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KRYEMINISTRI

Nr 287 prot
Datë 19.04.24

URDHËR

Nr. 58, datë 18.4.2024

PËR

MIRATIMIN E STRUKTURËS DHE TË ORGANIKËS SË AGJENCISË KOMBËTARE TË RINISË

Në mbështetje të pikës 3, të nenit 102, të Kushtetutës, të nenit 10, të ligjit nr.9000, datë 30.1.2003, “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave”, dhe të nenit 21, të ligjit nr.90/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore”,

URDHËROJ:

1. Struktura e Agjencisë Kombëtare të Rinisë të jetë sipas skemës 1, që i bashkëlidhet këtij urdhri dhe është pjesë përbërëse e tij.
2. Organika e Agjencisë Kombëtare të Rinisë të jetë sipas skemës 2, që i bashkëlidhet këtij urdhri dhe është pjesë përbërëse e tij.
3. Numri i punonjësve të Agjencisë Kombëtare të Rinisë të jetë, gjithsej, 30 veta.
4. Urdhri nr.163, datë 14.12.2020, i Kryeministrit, “Për miratimin e strukturës dhe organikës së Agjencisë Kombëtare të Rinisë”, i ndryshuar, shfuqizohet.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI

EDIRAMA

